

Dobrilla Popović

Milosh Zatkallik

Darko Todić

Kultura muzikore 9

Tekst mësimor për klasën e nëntë të shkollës fillore nëntëvjeçare

Manuali për mësuesit



Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore
PODGORICË, 2009

Mr. Dobrilla Popoviq Dr. Millosh Zatkallik Darko Todiq

Kultura Muzikore 9

Për klasën e nëntë të shkollës fillore nëntëvjeçare

MANUALI PËR MËSUESIT

Музичка култура 9

За девети разред деветогодишње основне школе

PRIRUČNIK ZA NASTAVNIKE

Botuesi	Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë
Kryeredaktore dhe redaktore përgjegjëse	Natasha Zhivkoviq
Redaktore	Mr. Vedrana Markoviq
Recensentë	Dr. Vesna Vuçiniq Dr. Ivan Drobni Nada Markoviq Radmilla Bajkoviq Natasha Gazivoda
Grafika e notave	Aleksandër Taminxhiq
Përkthyes	Dimitrov Popoviq
Redaktor teknik	Rajko Radulloviq
Për botuesin	Nebojsa Dragoviq
Disenjoja	Bilana Zhivkoviq
Përgatitja grafike	Studio “Mouse” - Podgoricë
Shtypi	Studio “Mouse” - Podgoricë
Tirazhi	50
ISBN	978-86-303-1425-4

PËRMBAJTJA:

Parathënie	4
Ora hyrëse (1)	10
Muzika në gjysmën e dytë të shekullit XIX	11
Shkollat kombëtare, Aleksandër Borodini (2)	11
Modest Musorgski (3)	13
Punimi i këngës: <i>O, ti dushkajë e errët</i> , Rimski-Korsakov (4)	13
Bedzhih Smetana (5)	15
Antonin Dvorzhak (6)	16
Eduard Grig dhe Manuel de Fala (7)	17
Muzika në hapësirën sllavojugore në gjysmën e dytë të shek. XIX	18
Punimi i këngës: <i>Fluturo sokol</i> , këngë popullore malazeze (8)	18
Impresionizmi	19
Klod Debysi (9)	19
Moris Ravel (10)	20
Punimi i këngës: <i>Këngë spanjolle</i> , M. Ravel (11)	21
Muzika në shekullin XX	22
Arnold Shenberg (12)	22
Igor Stravinski (13)	23
Punimi i këngës: <i>M'ka shku mendja me u feju</i> , këngë popullore shqiptare (14)	24
Bella Bartok (15)	26
Sergej Prokofjev – Karl Orf (16)	27
Punimi i të ushtruarit ritmik: <i>Rondo</i> , Karl Orf (17)	28
Oliver Mesian dhe Benxhamin Britën (18)	29
Tendencat e reja (19, 20, 21)	30
Muzika në Mal të Zi në shekullin XX	
(punimi i këngës: <i>Prođoh kroz goru</i> (Kalova nëpër mal), këngë popullore malazeze (22)	31
Xhez muzika (23, 24)	32
Punimi i këngës: <i>Summertime</i> , Xh. Gershvin (25)	35
Muzika popullore (26)	36
Muzika filmike (27)	37
Kanon – <i>Dona nobis Pacem</i> (28)	38
Literatura	39



PARATHËNIE

Kompleti i mjeteve mësimore për lëndën Kultura Muzikore për klasën IX përmban **Tekstin Mësimor** me dy CD për nxënësit, si edhe **Manualin** dhe dy CD për mësuesit.

Manuali për mësuesit është menduar si mjet ndihmës e praktik në krijimin, planifikimin, ekzekutimin dhe vlerësimin e mësimi sipas Planit dhe programit të miratuar. Në të është treguar struktura orientuese e orës për çdo njësi mësimore, me elementet e duhura didaktiko-mësimore për realizimin e tyre. Njësitë mësimore janë punuar në trajtën përgatitore me detyrat e propozuara, me mjetet mësimore dhe metodat standarde.

Manuali nuk i jep të gjitha mundësitë e punës për lëndën Kultura muzikore, por krahas konceptit të vet dhe metodës së mësuesit duhet të shërbejë si burim frymëzimi dhe sajimi si mundësi kalimtare idesh për një punë pedagogjike me efikasitet. Në fushën profesionale dhe metodike të mësimi të Kulturës muzikore ndodhin vazhdimisht inovacione të cilat mësuesit, sipas rrethanave të veta, do t'i bëjnë pjesë përbërëse të punës së vet. I parë në këtë prizëm, Manuali është menduar si bazë orientuese, në të cilën edhe më tej mund të sëndërtohen zgjidhje të reja metodike dhe të zhvillohen aftësitë pedagogjike.

DËGJIMI I MUZIKËS

Kushtëzuar me Planin dhe programin, që përmbledh zhvillimin e rrjedhës muzikore në gjysmën e dytë të shekullit XIX dhe XX (spektër i ndryshëm i stileve dhe i formave muzikore, nga romantizmi i vonë deri te muzika moderne e shekullit XX), njëri nga aspektet më të rëndësishme të studimit të përmbajtjes së mësimi të Kulturës muzikore në klasën IX të shkollës fillore nëntëvjeçare mbështetet në dëgjimin aktiv dhe të orientuar të kompozimeve muzikore (në ndryshim nga dëgjimi i muzikës në funksionin relaksues, dëfryes dhe argëtues) gjegjësisht pjesëve të tyre dhe njëkohësisht analiza e tyre, pavarësisht nga detyrat e vëna edukativo-arsimore.

Kompozimet muzikore të vëna në CD janë përfaqësuar në atë masë dhe vëllim që i përgjigjet moshës, aftësive dhe kujdesit të nxënësve, megjithëse edhe këtu duhet të nënvizohet se është fjala për procese në zhvillim që ndërrohen nga ana cilësore dhe sasiore, modelohen - të mësuarit duhet të jetë ajo forcë lëvizëse e cila **begaton dhe fisnikëron personalitetin e nxënësit**.

Me dëgjimin aktiv dhe të orientuar të muzikës, nxënësit **aftësohen** që:

- të përshkruajnë dhe të shprehin përjetimin muzikor;
- të analizojnë strukturën themelore të veprës muzikore;
- të përshkruajnë atmosferën e veprës;
- të japin karakteristikat themelore të muzikës;
- të zbulojnë përdorimin funksional të elementeve të caktuara muzikore;
- emërojnë ekzekutuesit dhe instrumentet; krahasojnë, vërejnë cilësitë, dallimet dhe ngjashmëritë mes stileve dhe formave të ndryshme muzikore.

Pas njohjes së nxënësit me veprat muzikore të periudhës së dhënë, duhet që mësuesi me detyra të sakta të orientojë nxënësit në dëgjimin e shembujve të zgjedhur dhe jashtë procesit mësimor. Në këtë mënyrë nxënësit nxiten që me **inisiativën e vet** të dëgjojnë muzikë artistike, të ndjekin koncertet dhe ngjarjet e tjera muzikore dhe më tej të zhvillojnë sensibilitetin dhe të modelojnë kriteret e veta estetike.

Meqenëse potenciali motivues dhe asociativ i muzikës është i madh si dhe aftësia e ndikimit të saj në të gjitha sferat e komplikuar të personalitetit të njeriut, nxënësit duhen nxitur gjithashtu në **të shprehurit letrar, figurativ dhe motorik të përjetimit muzikor**, me çfarë realizohet edhe **parimi i korelacionit** (lidhjes) me lëndët e tjera mësimore, ndërsa mundëson zhvillimin integral e tërësor të personalitetit të tyre.

EKZEKUTIMI I MUZIKËS

Përveç qasjes receptive, analizës dhe studimit të përmbajtjeve të Kulturës muzikore, shtrirja e së cilës është nga përjetimi muzikor gjatë dëgjimit të orientuar e deri tek kritika artistike e veprave muzikore, ku formohen, zbërthehen dhe zhvillohen modele specifike të vlerave estetike të lidhura me sferën e muzikës, aspekt njësoj të rëndësishëm të studimit të Kulturës muzikore përmbledh **zhvillimi i aftësive interpretuese, riprodhuese dhe krijuese të nxënësit.**

Aspekti riprodhues i studimit përmbledh; ritmikën, këndimin dhe ekzekutimin e pjesëve muzikore etj. **Aspekti krijues**, kreativ i studimit përmbledh komplet një grup aktivitete, duke filluar nga futja e elementeve të reja melodike dhe ritmike në veprat ekzistuese, rikombinimi, ndërrimi i thekseve etj. deri tek hapat e parë të krijimit të formave të reja autentike e origjinale. Tek këto pjesë të punës në orën mësimore, mësuesi mund të nxitë nxënësit në lojën krijuese, duke modeluar me ta ritme jetësore dhe tinguj në fillim të muzikës.



PROCEDIMI METODIK GJATË PUNIMIT TË KËNGËS SIPAS TEKSTIT ME NOTA

Me rastin e punimit të këngës sipas tekstit me nota, do ta përqendrojmë vëmendjen në disa porosi të rëndësishme për arsye të përvetësimit më të mirë dhe më të lehtë të kësaj njësie mësimore.

Hapi i parë ka lidhje me nxitjen e motivimit, kureshtjes dhe interesimit të nxënësve që të marrin pjesë aktivisht në mësimin e këngës. Për këtë është me interes të shfrytëzohen ilustrimet, tekstet e përshtatshme, bisedat e shkurtra, këngët e punuara më përpara dhe mjete të tjera mësimore lëndore-praktike të lidhura me punimin e përmbajtjes. Në këtë mënyrë nxënësit do të mbajnë mend më lehtë dhe do të përvetësojnë tekstin me nota dhe intonacionin e qartë.

Kur mësuesi të thotë emrin e këngës, duhet të kërkojë që ndonjë nga nxënësit të lexojë qartë dhe saktë tekstin e saj. Nëse në tekst ka fjalë të panjohura, duhet të sqarohet kuptimi i tyre.

Gjatë analizës së tekstit me nota nxënësit dallojnë llojet e taktit, shkallën në të cilën është shkruar kënga, vlerën e notave të përfaqësuara në këngë, shenjat për tempin dhe dinamikën, përsëritjet, prima dhe sekonda voltën etj. Nëse ekzistojnë vlera ritmike të panjohura ose fenomene, është e domosdoshme që mësuesi t'i sqarojë.

Kur të mbarojë analiza e tekstit të notave, ritmi i këngës punohet në një rrokje neutrale. Nëse ritmi dhe teksti me nota është i qartë për të gjithë, ushtrimi në rrokjen neutrale mund të mos bëhet, ndërsa kënga ekzekutohet parlato. Leximi parlato i këngës nënkupton shqiptimin solmizues të notave me taktim të detyrueshëm.

Para këndimit të këngës me solmizim, mësuesi duhet t'u kujtojë nxënësve se si duhet qëndruar gjatë të kënduarit. Për këndim mund të shfrytëzohet shkalla në të cilën është shkruar kënga ose ndonjë model tjetër i shkurtër. Pas kësaj, këngën duhet ta përvetësojnë me fraza ose tërësi të vogla, deri sa nxënësit ta mësojnë mirë. Nëse ndodh që nxënësit gabojnë gjatë të kënduarit, mësuesi duhet që t'i ndalë e të mos e mësojnë gabimisht këngën. Këndimi me solmizim duhet të përcillet me taktim. Vijon hapi në të cilin bëhet shqiptimi solmizues i notave, me taktim të detyrueshëm.

Faza e fundit është puna në këndimin ekspresiv: kënga ekzekutohet në temp, me tone të modeluara dhe dinamikë të theksuar.

ANALIZA E FORMËS SË KËNGËS

Gjatë punimit të këngës nga nxënësit duhet të kërkohet të vërejnë formën në të cilën është shkruar kënga. Meqenëse në klasat e mëparshme kanë përvetësuar dije që lidhen me strukturën e melodisë – fjalia, periudha, dytakti, është e domosdoshme që në fund të definimit të tonalitetit të vërejnë formën e këngës që punohet.

FORMIMI I GRUPEVE

Puna me grupe në orët mësimore është e kushtëzuar nga qëllimet edukativo-mësimore dhe kërkesat didaktiko-metodike gjatë punimit të përmbajtjeve të caktuara mësimore kur e përfytyrojmë me formën më të përshtatshme të punimit dhe studimit në orët e Kulturës muzikore. Është e domosdoshme që mësuesi të vlerësojë kur ndonjë temë ose problem duhet të punohet përmes kësaj mënyre të organizimit të mësimit që të fitohet punimi më efikas i lëndës.

Me rastin e ndarjes së detyrave në grupe, mësuesi duhet qartë dhe preciz t'i futë në punë dhe, sipas nevojës t'i ndihmojë. Puna e grupeve nënkuptohet **intra-** (të brendshmen, mes anëtarëve të grupit dhe **inter** (të jashtmen, mes grupeve) koordinimin dhe kooperimin.

Në varësi nga rëndësia e detyrës dhe e përmbajtjes, grupet mund të formohen si:


1. **monolite** – kur gjithë nxënësit punojnë të njëjtën temë dhe kanë detyra të njëjta;
2. **të diferencuara** – kur grupe të veçanta fitojnë tema të veçanta dhe detyra, të cilat pastaj bëjnë një tërësi logjike.

Gjithashtu grupet mund të jenë homogjene ose heterogjene sipas përbërjes së nxënësve. Homogjenet bashkojnë nxënës me aftësi, dije e interesime të ngjashme. Kjo përdoret kur duam që secili të përparojë dhe të zhvillojë aftësitë e veta maksimalisht në kuadër të mundësive momentare. Kështu me këtë i afrohem realizimit të parimeve themelore të mësimit të diferencuar. Për t'u realizuar kjo me efikasitet, është e nevojshme të vërtetojmë dhe definojmë qëllimin edukativo-mësimor dhe detyrat, rezultatet e dëshiruara, nivelet e pritura të njohurive (sasia dhe cilësia), nivelet e zhvillimit të aftësive dhe të zotësive, sipas këtyre kategorive, përmes të cilave do të matej puna pedagogjike me nxënësit.

Grupet heterogjene përfshijnë nxënës të niveleve, interesimeve e aftësive të ndryshme (p.sh. nën mesatare, mesatare dhe mbi mesatare) etj.

Gjithashtu ekzistojnë edhe shumë lloje ujdishesh tek puna me grup. P.sh. dhënia e të dhënave të ndryshme për nivele të ndryshme aftësish dhe njohurish të nxënësve ose dhënia e të njëjtave detyra për të gjithë nxënësit, me atë që mësuesi cakton “dozën” e ndihmës për çdo nxënës gjatë përvetësimit të lëndës, pavarësisht nga mundësitë e tyre.





Literatura

Literaturën, me ndihmën e së cilës nxënësit do të punojnë përmbajtjet e caktuara, mund ta sigurojnë edhe vetë. Në këtë rast mësuesi para nxënësve vë një **qëllim** të definuar qartë dhe detyrat, i njofton për përmbajtjen e caktuar dhe i orienton në **burimet** përkatëse të informacioneve të duhura, jep instruksione të qarta si t'i qasen materialit që do të punohet, ku ta përqendrojnë vëmendjen, duke definuar detyrimisht vëllimin e materialit dhe nivelin e punimit. P.sh. për të mësuar për kompozitorin, mund të gjenden të dhëna interesante për jetën e tij, anekdota etj., për instrumentet për krijimin e tyre, mënyra e punimit, përdorimit, fitimit të tonit, ilustrimit, figurës etj.

MJETE TË VEÇANTA PËR REALIZIMIN E MËSIMIT

Për t'u realizuar përmbajtjet mësimore, është e domosdoshme që çdo kabinet për zhvillimin e mësimin të Kulturës muzikore të jetë i pajisur me një instrument autentik, një instrument elektrik (sintisajzer, kitarë elektrike), instrumentet orfeane, një pajisje të thjeshtë për incizim, CD plejer, aparat TV, video-rekorder ose DVD plejer. Në planizimin e mësimin duhet të shfrytëzohen maksimalisht potenciali i mjeteve që ka shkolla në dispozicion.

Nëse shkolla është e lidhur me internetin, në faqet e tij ka mundësi të gjinden shumë të dhëna rreth kompozitorëve dhe ekzekutuesve. Disa nga faqet web më interesante mund të gjenden në:

<http://www.classical.net>

<http://www.altavista.com/>

<http://www.wikipedia.org/>

<http://www.britannica.com/>

<http://www.netplugged.com>

<http://google.com/>



Ora hyrëse

Qëllimi mësimor:

- *dëgjimi dhe dallimi i veçorive të muzikës së epokave të ndryshme: rilindjes, barokut, klasicizmit, romantizmit
- *lidhja e lëndës nga klasat e mëparshme me të rene

Dëgjimi i muzikës:

1. V.A. Moxart, opera *Fyelli magjik*, aria e mbretëreshës së natës
2. J.S. Bah, tokata dhe fuga në d-mol
3. F. List, *Simfonia Faust*
4. O. Di Laso, *Eho*
5. Debisi, *More*
6. L. Armstrong, *What a Wonderful Word*

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
 2. dëgjimi i muzikës, njohja e stilit dhe e kompozitorit
 3. formimi i grupeve
 4. raportimet e grupeve
1. Të përsëriten me nxënësit lënda e mësuar në klasat e mëparshme. Njësia e fundit mësimore: Baleti dhe Çajkovski është lidhja me lëndën e klasës IX.
 2. Dëgjohen shembuj të shkurtër muzikorë që nxënësit i kanë mësuar në klasat e mëparshme. Pas çdo shembulli të komentohen: kush është autori, për cilën periudhë kohore bëhet fjalë, cilat janë veçoritë e stilit të asaj kohe. Nga nxënësit të kërkohet që në tabelë të krahasohen kronologjikisht shembujt e dëgjuar. Me shembujt e rinj (impresionizmi dhe xhezi) nxënësit futen në programin e klasës IX.
 3. Ndahen nxënësit në katër grupe me detyrë që secili grup të përgatitë përgjigjet për periudhën e dhënë, karakteristikat e stilit të saj, kompozitorët dhe veprat kryesore të tyre.
 4. Përfaqësuesit e grupeve paraqesin gojarisht, ndërsa mësuesi shkruan në tabelë: periudhën, autorin, veprën. Çdo ekspozim gojarisht e përcjell shembulli muzikor.

Pamja e tabelës:

I. Rilindja

Laso: motetet

Palestrina: Mesha e Papës Marqeli

II. Baroku

Hendel: oratoriumet, Muzika në ujë, Muzika për fishekzjarrët

Bah: fugat, pasionet, kantatat, koncertet

Vivaldi: Stinët e vitit

III. Klasicizmi

Hajden: simfonitë,

Moxart: simfonitë, operat

Bethoven: simfonitë, sonatat

IV. Romantizmi

Shubert: Këngët solo

Shopen: valset, polonezet, mazurkat

List: poemat simfonike

Vagner: operat

Çajkovski: baletet

SHKOLLAT KOMBËTARE

Aleksandër Borodin (2)

Qëllimi mësimor:

*njohja me krijimin dhe rëndësinë e shkollave kombëtare

*dallimi i karakteristikave të muzikës në gjysmën e dytë të shekullit XIX

*fitimi i njohurive për punën dhe veprën e A. Borodinit

Dëgjimi i muzikës:

1. M. Glinka, *Kamarinskaja*

2. Borodin: fragmente nga opera *Princi Igor*:

- kori fillestar, *Diellit të kuq*

- *Vallet e polovcëve*

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës

2. dëgjimi dhe analiza e muzikës së A. Borodinit

3. formimi i grupeve

4. raportimet e grupeve

1. Në pjesën hyrëse të orës nxënësve u përkujtohet periudha e romantizmit, në fazën e tij të fundit *romantizmi i vonë*, karakteristikat e tij dhe përfaqësuesit më të rëndësishëm, njofton krijimin e *shkollave kombëtare*.



2. Dëgjohet fragmenti nga kompozimi orkestral i Glinkës *Kamarinskaja*. Me anë të pyetjeve, nxënësit futen të vërejnë praninë e folklorit dhe të caktojnë se për cilin popull është karakteristike muzika që dëgjojnë. I informon mbi krijimin e shkollave kombëtare dhe u paraqet anëtarët e *pesëshes ruse*: nevojat e tyre për ndërtimin e stilit kombëtar në punimin e melodive dhe kompozimeve në frymën e muzikës popullore.

Dëgjohet fragmenti nga opera *Princi Igor* me qëllim që të njohin elementet e muzikës ruse dhe futjen në krijimtarinë e Borodinit. Kërkon nga një nxënës që të lexojë nga Teksti mësimor përmbajtjen e shkurtër të libretit të operës dhe pastaj të përsëritë nocionet themelore për operën dhe ekzekutimin e saj.

Pas dëgjimit të pjesës korale *Diellit të kuq* i pyet nxënësit si e përjetojnë muzikën dhe cila është përbërja e ekzekutuesve (melodinë e fuqishme dhe të vendosur e sjell kori i përzier). Komentohet roli i korit në operë.

Pas dëgjimit të *Vallet e pollovcëve* kërkon nga nxënësit të përshkruajnë atmosferën dhe të dallojnë se cila pjesë e libretit është. Shikojnë shkrimin e notave në Tekst dhe e lexojnë atë. Pas dëgjimit të dytë, komentohet ansambli ekzekutues: kori i grave- sopranet pastaj altet, pjesa orkestrale me vegla muzikore metalike me fryrje. Nxit nxënësit që të krahasojnë shembujt e dëgjuar.

3. Formon katër grupe me detyrë që çdo grup, duke shfrytëzuar Tekstin dhe materialin që disponon shkolla, informon nxënësit e tjerë për:

Grupi I - krijimin e shkollave kombëtare;

Grupi II - *Pesëshen ruse*;

Grupi III – krijimtarinë e Borodinit;

Grupi IV – për operën *Princi Igor*.

4. Përfaqësuesit e grupeve njohin të tjerët me njohuritë deri tek të cilat është arritur, ndërsa njëri nga nxënësit shkruan në tabelë informacionet më të rëndësishme.

Pamja e tabelës:

Shkollat kombëtare

Pesëshja ruse

Aleksandër Borodin - Princi Igor, simfonia nr. 2

Opera “Princi Igor”, skenat e mëdha, Vallet e pollovcëve

Modest Musorgski (3)

Qëllimi mësimor:

- *fitimi i njohurive mbi veprën e Musorgskit
- *dëgjimi me përjetim i muzikës

Dëgjimi i muzikës:

1. Borodin, fragmente nga opera *Princi Igor*
2. Musorgski, fragment nga opera *Boris Godunov*
 - Vdekja e Borisit
 - skena *Nën kromët*
2. Piktura të një ekspozite
 - Qerrja*
 - Promenada*, ekzekutimi me piano
 - Promenada*, ekzekutimi orkestral (orkestra e Ravelit)
 - Gjyshe Jaga*

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
2. nxitja e nxënësve për të menduar e biseduar për kompozimet e dëgjuara
3. të shprehurit figurativ të përjetimit të *Gjyshe Jagës*
4. zgjedhja e punimeve më të mira

1. Dëgjimi i fragmentit nga opera e Borodinit *Princi Igor* dhe u kujton nxënësve shkollat kombëtare dhe *Pesëshen ruse*.
2. Dëgjimi i fragmentit nga opera *Boris Godunov* dhe pastaj të pyeten nxënësit se për cilën formë muzikore bëhet fjalë, cili zë këndon dhe çfarë atmosfere pasqyron muzika. Bisedohet për praninë e folklorit rus. Pas kësaj i informon për krijimtarinë e Musorgskit. Para dëgjimit të dytë, një nxënës lexon përmbajtjen e shkurtër të libretit nga teksti mësimor. Pas dëgjimit të shembullit, nxënësit pyeten se cilat mjete ka përdorur kompozitori për përshkrimin e vdekjes së Borisit, cilën mënyrë të të kënduarit ka zbatuar (recitative), a kanë vërejtur pjesëmarrjen e korit, lutjen në prapaskenë, kreshendon. Dëgjohet shembulli muzikor, pjesa korale *Nën kromët* dhe bisedohet për përjetimin, për rolin e korit në operë, ansamblit të burrave dhe të grave. Dëgjojnë edhe një herë shembullin me qëllimin që të lidhen pjesët e dëgjuara dhe të krijojnë përshtypjen e përgjithshme për operën.

Në vazhdim të dëgjohet *Qerrja* nga *Piktura të një ekspozite* dhe pastaj fillon diskutimin për muzikën: si është përjetimi, si është atmosfera dhe në çfarë i asocion muzika. U sqaron nxënësve ç'është qerrja (bidllo), qerre për tërheqje, me rrota të mëdha që tërhiqet nga qetë). Dëgjohet edhe njëherë shembulli dhe pastaj pyeten se cilit lloj të muzikës i përkasin shembujt e dëgjuar me emërtimin e caktuar më parë (muzika programore) dhe si i quajmë kompozimet e përbëra nga shumë pjesë të veçanta (ciklike). U shpjegon nxënësve si u krijua *Piktura të një ekspozite* dhe funksionin e *Promenadës* e cila shfaqet shumë herë si udhëheqës i veçantë në vepër. Dëgjohet promenada në ekzekutim orkestral dhe pianistik, pastaj krahasohet dhe komentohet. Shikohet shembulli me nota në libër dhe këndohet. Informon nxënësit se punimin



orkestral *Piktura të një ekspozite* e ka bërë Moris Ravel (në vitin 1922).

3. Dëgjojnë *Gjyshe Jagën*, njërën nga pjesët e *Piktura të një ekspozite*, duke mos e thënë emërtimin dhe kërkohet nga nxënësit që të shprehin përjetimin e vet me vizatim. Pas kryjes së detyrës, i njofton se për cilën pjesë bëhet fjalë dhe krahasohen vizatimet me emërtimin e veprës.
4. Zgjidhen punimet më të mira, varen në tabelë dhe komentohen.

Pamja e tabelës:

Modest Musorgski

Boris Godunov

Piktura të një ekspozite – Qerrja, Promenada, Gjyshe Jaga

Punimi i këngës: *O, ti dushkajë e errët*, Rimski-Korsakov (4)

(nga opera *Sadko*)

Qëllimi mësimor:

- *këndimi i këngës sipas tekstit me nota
- *zhvillimi i aftësive interpretuese
- *dallimi i elementeve folklorike në këngën artistike

Dëgjimi i muzikës: 1.

O, ti dushkajë e errët

- ekzekutim vokalo-instrumental

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
2. analiza e tekstit me nota
3. punimi i ritmit
4. këndimi sipas shënimit me nota
5. formimi i grupeve dhe ekzekutimi nga ana e tyre
6. dëgjimi i këngës nga CD-ja

1. Orën e fillon me njërën nga këngët e mësuara në klasat e mëparshme me qëllim që të këndojnë gjithë nxënësit.
- 2, 3 dhe 4. Sipas procedimit metodik të dhënë në Hyrje të Manualit, të punohet kënga e re.
5. Formohen tri grupe me detyrë që, sipas radhës së caktuar, çdo grup të këndojë strofën e vet me shoqërim instrumental nga CD-ja.
6. Para dëgjimit të regjistrimit të zërit, këngës nga CD-ja, i informon nxënësit për autorin e muzikës Rimski-Korsakov dhe rolin e tij në shkollat kombëtare. Lidh veprimtarinë e Korsakovit me atë të Musorgskit.

Bedzhih Smetana (5)

Qëllimi mësimor:

- *fitimi i njohurive mbi krijimtarinë e Smetanës
- *dëgjimi me përjetim i muzikës

Dëgjimi i muzikës:

1. Smetana, *Vlltava*
2. fragmentet nga opera *Nusja e shitur*
 - kori hyrës
 - dueti i Kecalit dhe Janjikut

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
2. dëgjim dhe analiza e muzikës së B. Smetanës
3. formimi i grupeve
4. ekzekutimi i pjesës

1. Në pjesën hyrëse të dëgjohej një fragment nga *Vlltava* (i punuar në klasën VI). Pas identifikimit të autorit dhe të veprës, bisedohet për rëndësinë dhe vlerën e shkollave kombëtare dhe vendeve evropiane që kanë hypur në skenën muzikore në gjysmën e dytë të shekullit XIX.
2. Sipas fragmentit të dëgjuar të korit hyrës nga *Nusja e shitur*, bisedohet për melodinë, aparatën ekzekutues dhe karakterin e veprës. I fut nxënësit të vërejnë elementet folklorike. Me pyetje të lidhura për strukturën e operës, pjesëve dhe ekzekutuesve, përsërisin këtë formë muzikore. Para dëgjimit të përsëritur, kërkon që një nxënës të lexojë libretin e pastaj nxënësit të lidhin elementet e tekstit dhe të muzikës. Shembulli i dytë, dueti i Kecalit dhe Janjikut, të dëgjohej me të njëjtën detyrë të lidhjes së tekstit me muzikën si dhe përcaktimin e situatës në të cilën zhvillohet veprimi. Të analizohet regjistrimi i notave në Tekstin mësimor dhe të këndohet pas dëgjimit të përsëritur.
3. Të formohen katër grupe: dy me djem dhe dy me vajza, me detyrën që:
 - Grupi I i djemve të ushtrojë melodinë e Kecalit;
 - Grupi II i djemve të ushtrojë melodinë e Janjikut;
 - Grupi III i vajzave të mendojë për koreografinë;
 - Grupi IV i vajzave të mendojë për përcjelljen ritmike me instrumentet orfeane.
4. Ekzekutimi i pjesës me bashkimin e grupeve e pastaj ekzekutimi me incizimin nga CD-ja.

Pamja e tabelës:

Bedzhih Smetana
Nusja e shitur, Vendlindja ime- Vlltava



Antonin Dvorzhak (6)

Qëllimi mësimor:

- *fitimi i njohurive mbi krijimtarinë e A. Dvorzhakut
- *dëgjimi me përjetim i muzikës

Dëgjimi i muzikës:

1. Smetana, fragment *Nusja e shitur*
2. Dvorzhak, koncert për ballo dhe orkestër, finale (tema)
3. Dvorzhak, Simfonia *Nga bota e re*, pjesa II, Largo

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
2. dëgjim dhe motivim i nxënësve në analizën e muzikës së Dvorzhakut
3. formimi i grupeve
4. raportimet e grupeve

1. Të dëgjohet shembulli i Smetanës që nxënësit të përkujtojnë veprën e tij dhe rëndësinë e saj për muzikën çeke dhe pastaj të futë nxënësit në krijimtarinë e bashkëatdhetarit të tij, Dvorzhakut.

2. Të dëgjohet fragmenti nga finalja e koncertit për ballo e orkestër e pastaj të bisedohet për temën, karakterin e saj dhe elementet e folklorit. Pas dëgjimit të dytë, përsëritet forma muzikore koncert, sipas mundësisë me ekzekutimin me violonçel dhe të bisedohet mbi raportin e solistit me orkestrën.

Informon nxënësit mbi momente nga jeta e Dvorzhakut. Të dhënat biografike të lidhen me krijimin e veprave të veçanta, konkretisht të simfonisë *Nga bota e re*. Pas dëgjimit kërkon nga nxënësit që të karakterizojnë temën, të njohin instrumentin që e sjell (oboa) dhe përshkruajnë atmosferën. Analizojnë dhe këndojnë temën *Largo* nga Teksti mësimor dhe informojnë nxënësit që kënga shpirtërore zezake i ka shërbyer Dvorzhakut si frymëzim. Përsëritet dëgjimi me këndimin në brum.

3. Të formohen tri grupe me detyrën që me ndihmën e Tekstit dhe literaturës që disponojnë të përgatisin informacionet:

Grupi I – për kompozitorin;

Grupi II – për koncertin me violonçel;

Grupi III – për simfoninë *Nga bota e re*

4. Raportimet e grupeve dhe pastaj të gjithë nxënësit këndojnë temën *Largo* me zë krahas incizimit nga CD-ja.

Pamja e tabelës:

Antonin Dvorzhak

Koncert për violonçel, simfonia “Nga bota e re”

Eduard Grig dhe Manuel de Fala (7)

Qëllimi mësimor:

- *fitimi i njohurive mbi krijimtarinë e E. Grigut dhe M. de Fales
- *dëgjimi me përjetim i muzikës

Dëgjimi i muzikës:

- Grig, Koncert pianistik në a-mol, koha I
- 2. Fala, *Loja e zjarrit*, nga baleti *Dashuria e magjistareve*

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
2. dëgjimi dhe analiza e muzikës së Grigut dhe de Fales
3. formimi i grupeve
4. përfaqësimet e grupeve

1. Të dëgjohet fillimi i koncertit pianistik në a-mol me synimin që nxënësit të njohin se cilit lloj i përket muzika. Duke biseduar për formën muzikore, koncertin, ta njohin Grigun si krijuesin e një prej koncerteve më të bukura në literaturën e shkruar për piano.

2. Pas dëgjimit të dytë të analizojnë temën, karakterin e saj dhe raportin solist orkestër. Të pyeten nxënësit për të thënë koncertet më të rëndësishme pianistike (të Bahut, Bethovenit, Shumanit, Shopenit, Listit, Çajkovskit) si edhe për pianistë të tjerë që kanë dëgjuar. Në bazë të tekstit nga Libri, nxënësit informohen për krijimtarinë e Grigut dhe pastaj një nxënës lexon nga Teksti mësimor se çfarë ka shkruar Grigu për muzikën e vet.

Të dëgjohet *Loja e zjarrit* nga baleti i de Fales dhe kërkon nga nxënësit të përshkruajnë përjetimin. Kërkon nga nxënësit të njohin elementet e folklorit spanjoll. I pyet nxënësit se në çfarë i asocion emërtimi i veprës dhe të përsëritet baleti si formë muziko-skenike.

U thotë nxënësve përmbajtjen e shkurtër të baletit me qëllim që pas dëgjimit të përcaktojnë se cilën pjesë të përmbajtjes përshkruan muzika. Me ndihmën e Tekstit mësimor informohen mbi krijimtarinë e de Fales.

3. Të formohen grupe me 5-6 nxënës me detyrë të përbashkët që çdo grup të përfytyrojë koreografinë për *Lojën e zjarrit*.

4. Çdo grup ekzekuton mendimin (zgjidhjen) e vet për koreografinë me muzikën nga CD-ja.

Pamja e tabelës:

Eduard Grig: Per Gynt, koncert pianistik në a-mol

Manuel de Fala: baleti “Kapela trebrirëshe”, Dashuria e magjistareve



MUZIKA NË HAPËSIRËN SLLAVOJUGORE NË GJYSMËN E DYTË TË SHEK. XIX

Punimi i këngës: *Fluturo sokol*, këngë popullore malazeze (8)

Qëllimi mësimor:

- * fitimi i njohurive mbi zhvillimin e muzikës në hapësirën sllavojugore, me theks në muzikën e Malit të Zi
- * këndimi sipas tekstit me nota: *Fluturo sokol*
- * zhvillimi i aftësive interpretuese
- * dallimi i veçorive të këngëve popullore të bregdetit

Dëgjimi i muzikës:

1. S. Mokranjac, *Tufa IX- Fushës lërohet*
2. D. de Sarno, arie e Danicës, nga opera *Perandoresha e Ballkanit*
3. Mirko Petroviq, *Vallja ime*
4. *Fluturon sokoli*, këngë popullore malazeze
- ekzekutimi vokalo-instrumental

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
 2. njohja me krijimtarinë e kompozitorëve të hapësirës sllavojugore
 3. dëgjimi analitik i muzikës
 4. analiza e tekstit me nota
 5. punimi i ritmit
 6. këndim sipas shënimit me nota
 7. Dëgjimi i këngës nga CD-ja
1. Dëgjimi i fragmentit nga tufa IX e Mokranjcit, me anë pyetjesh që lidhen me njohjen e hapësirave nga rrjedhin ato këngë, informon nxënësit mbi autorin dhe futet tematikisht në njësinë mësimore.
 2. Duke u mbështetur në Tekstin mësimor, informon nxënësit për kompozitorët nga hapësirat sllavojugore, me theks të veçantë tek autorët nga Mali i Zi.
 3. Dëgjohet aria e Danicës nga opera *Perandoresha e Ballkanit* dhe *Vallja ime* pastaj bisedohet me nxënësit për përjetimin muzikor. Përsëritet dëgjimi me qëllimin që të njohin elementet e folklorit në kompozimet e autorëve nga Mali i Zi, të krahasojnë karakterin e kompozimeve dhe të interpretojnë tekstin e aries.
 - 4, 5. dhe 6. Punohet kënga e re me procedimin metodik të propozuar.
 7. Dëgjohet kënga e punuar nga CD-ja për një përjetim më të plotë dhe bisedohet për veçoritë e këngëve popullore nga bregdeti.

Pamja e tabelës:

Muzika në hapësirën sllavojugore
Mokranjac
Lisinski, Zajc
De Sarno, M. Petroviq

IMPRESIONIZMI

Klod Debysi (9)

Qëllimi mësimor:

- *njohja e nxënësve me karakteristikat themelore të impresionizmit
- * dëgjimi, analiza dhe dallimi i veçorive të muzikës të K. Debysisë
- * fitimi i njohurive mbi punën dhe veprën e K. Debysisë

Dëgjimi i muzikës:

1. K. Debysi – *Natë me hënë*
2. K. Debysi – *Pasdite e një fauni*

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
2. njohja e nxënësve me fillimin e drejtimit të stilit impresionizëm
3. dëgjimi dhe analiza e muzikës së K. Debysisë
4. formimi i grupve
5. raportime

1. Dëgjohet një fragment nga kompozimi *Natë me hënë* (por pa e prezantuar kompozitorin), pastaj i pyet se pse është muzikë e veçantë, në çfarë dallohet nga muzika e dëgjuar deri tani dhe a mund të thonë përafërsisht se për cilën formë është fjala.
2. Duke u prezantuar nxënësve arritjet shoqërore, kulturore dhe artistike në fund të shekullit XIX, nxënësve u sqarohen motivet për fillimin e stilit të ri. I njeh me stilin në bashkëpunim me piktorët, shkrimtarët dhe kompozitorët e asaj kohe.
3. Përsëri dëgjohet kompozimi *Natë me hënë*. Pyeten si është atmosfera dhe se çfarë emërtimi do t'i jepnin kësaj vepre. Në bazë të tekstit nga Libri, nxënësit informohen për krijimtarinë e kompozitorit Klod Debysi.

Ridëgjohet *Pasdite e një fauni*. Mësuesi u tregon emërtimin e kompozimit duke i sqaruar se Fauni është përëndia e pyjeve, livadheve, pjellorisë së jetës dhe mbrojtësi i çobanëve tek italet e vjetër. Në mitologji shfaqen shumë perëndi të tilla faunë, prandaj prej këtu merret edhe emërtimi i veprës *Pasdite e një fauni*. Njëri nga nxënësit do të lexojë tekstin e veprës nga libri. Përsëritet dëgjimi me synimin që të kihet kujdes në linjën metodike, asocimi që krijon instrumenti i zgjedhur (flauti-çobani) njihet harpa, dallojnë ngjyrat e tingujve që prodhon muzika dhe përpiqen që të caktojnë shkallën (dur apo mol). Informohen nxënësit për shkallët që ka përdorur Debysia, prandaj të shikohen në Tekstin mësimor modelet e shkallëve të propozuara. Shembujt e shkallëve ekzekutohen me instrumentet që kanë në dispozicion dhe krahasohen.



- 4., 5. Ndahen nxënësit në grupe me detyrën që të përgatisin raportime të shkurtra:
Grupi I - veçoritë e impresionizmit
Grupi II – krijimtarinë e Debysisë
Grupi III - *Preludi për pasditen e një fauni*, komenti i shoqëruar me një shembull me zë

Pamja e tabelës:

Impresionizmi
Klod Debysi
Natë me hënë, Pasdita e një fauni

Moris Ravel (10)

Qëllimi mësimor:

- * fitimi i njohurive për punën e Ravelit dhe roli i tij në impresionizëm
- * dëgjimi me përjetim i muzikës së Ravelit
- * analiza dhe dallimi i elementeve të veçanta në veprën muzikore

Dëgjimi i muzikës::

1. K. Debysi, *Natë me hënë*
2. M. Ravel, *Bolero*

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
 2. prezantimi i punimeve të M. Ravelit
 3. dëgjimi i muzikës së M. Ravelit në diktimin ritmik
 4. formimi i grupeve me detyrën që me lëvizje të shprehin përjetimin muzikor të *Boleros*
1. Dëgjohet fragmenti nga *Natë me hënë* të Debysisë me qëllim që nxënësit të kujtojnë drejtimin e stilit të impresionizmit.
 2. Dëgjohet fragmenti i *Boleros* dhe i fut nxënësit të dëgjojnë elementet e folklorit spanjoll, temën që përsëritet vazhdimisht, atmosferën dhe rregullimi impresionist i kompozimit. Mbi bazën e tekstit në libër, nxënësit informohen mbi punën dhe veprën e Moris Ravelit.
 3. Dëgjohet një pjesë e *Boleros* së Ravelit me detyrë që të shikojnë me vëmendje linjën karakteristike ritmike. Kërkon të përsëritet ritmi, sipas kujtimit (në rrokjen neutrale ose trokitjen me duar, me lapës mbi bankë). Dëgjojnë edhe një herë fragmentin nga *Bolero* dhe pastaj në trajtën e diktatit ritmik të shkruajnë ritmin pulsant. I pyet nxënësit pse shfaqja e pranishme e temës nuk e bën temën njëtrajtëshe (temën e sjell gjithmonë instrumenti i ri, i cili pas mbarimit, tërhiqet dhe plotëson shoqërimin) dhe a i njohin instrumentet që ekzekutojnë temën.

4. Nxënësit i ndan në 5-6 grupe me detyrë që secili grup të përfytyrojë lëvizjen dhe ta tregojë gjatë ekspozimit të një teme. Grupet ndërrohen, ashtu si ndërrohen instrumentet që e sjellin temën, ndërsa në kadencë me shkallëzimin dinamik luajnë të gjithë bashkë.

Pamja e tabelës:

Moris Ravel
Bolero
Shkrimi i linjës ritmike të *Boleros*

Punimi i këngës: *Cansion espanol (Këngë spanjolle), M. Ravel (11)*

Qëllimi mësimor:

- * këndimi i këngës sipas tekstit me nota
- * zhvillimi i aftësive interpretuese
- * dallimi i elementeve të folklorit spanjoll në këngën artistike

Dëgjimi i muzikës:

1. M. Ravel, *Këngë spanjolle*
- ekzekutimi vokalo-instrumental

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
2. analizë e tekstit me nota
3. punimi i ritmit
4. të kënduarit sipas tekstit me nota
5. formimi i grupeve dhe ekzekutimi
6. dëgjimi i këngës nga CD-ja

1. Ora duhet të fillojë me përsëritjen e njëjës nga këngët e mësuara në klasat e mëparshme që nxënësit të këndojnë dhe të futen në atmosferën e këngës.
- 2, 3. dhe 4. Me procedimin metodik të propozuar të punohet kënga e re. Duke menduar se nxënësit e klasës së kryer kanë mësuar dy gjuhë botërore, teksti të lexohet në gjuhën spanjolle.

Adios men homino, adios,
Ja qui te marchas pr'a guerra.
Non t'olvides d'aprendina
Qui che qued' a cava terra.

Lamtumirë njeriu im
Ti që nisesh për në luftë.
Mos harro bashkëshorten
Që mbeti në vatrën tënde.

Castellanos de Castilla
tratade ben nos gallegos:
cando van, van como rosas,
cando ven, ven como negros.

Kastelanë nga Kastila
Qëndroni t'mir' me ne t' Galicisë:
Kur largoheni shkoni si trëndafila
Dhe kur ju ktheheni, vini porsi pishtarë.



5. Formohen tri grupe me detyrë që sipas radhës së caktuar çdo grup të këndojë këngën me shoqërimin instrumental nga Cd-ja. Zgjidhen ekzekutuesit më të mirë.
6. Para dëgjimit të regjistrimit të zërit gjatë punimit të këngës nga CD-ja, nxënësit shprehin informacione lidhur mbi krijimtarinë e Ravelit.

Arnold Shenberg (12)

Qëllimi mësimor:

- * fitimi i njohurive për veprën e A. Shenbergut
- * dëgjimi me përjetim i muzikës
- * njohja me teknikën dodekafonike

Dëgjimi i muzikës:

1. A. Shenberg, *Pjeri somnambul*
2. A. Shenberg, *Të mbijetuarit e Varshavës*

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
2. nxitja e nxënësve në arsyetim dhe bisedë për kompozimet e dëgjuara
3. Njohja me krijimtarinë e A. Shenbergut
4. formimi i grupeve
5. puna me më të suksesshmit

1. Dëgjohe fragmenti nga vepra *Pjeri somnambul* dhe pastaj pyeten nxënësit: çfarë përshtypjesh ju ka lënë muzika, ku ndryshon nga muzika që keni dëgjuar deri tani dhe çfarë atmosfere prodhon.
2. Para dëgjimit të dytë informon nxënësit se kanë dëgjuar muzikën e Shenbergut që është shokante dhe krejt ndryshe, sepse është e ndërtaur në një teknikë të re kompozimi. Para dëgjimit të përsëritur vën detyrë që të përshkruajnë mënyrën e ekzekutimit nga solisti. I fut nxënësit të dallojnë që në këtë vepër Shenbergu përdor teknikën e “zërit tregues”, në të cilën këngëtari nuk e ekzekuton muzikën në mënyrën klasike, por prek tingujt duke rrëshqitur nga lart e nga poshtë.
3. Dëgjohe fragmenti nga *Të mbijetuarit e Varshavës*, pastaj kërkon nga nxënësit që të thonë përshtypjet. Në bazë të tekstit nga Libri, nxënësit njihen me krijimtarinë e Shenbergut dhe rëndësinë e muzikës së tij. U përkujton “shkollën vjeneze” dhe informon se Shenbergu dhe nxënësit e tij paraqesin një “shkollë tjetër vjeneze”. Teknikën e dodekafonisë – vargu dymbëdhjetësh do ta sqarojë duke shfrytëzuar shembullin nga Teksti mësimor. Dëgjohe edhe një herë fragmenti me detyrën që të vërejnë se cilat instrumente dhe në çfarë mënyre ekzekutojnë muzikën si dhe çfarë asociimesh krijojnë ajo.
4. Formojnë grupet me nga 3-4 nxënës me detyrë që çdo grup të krijojë vargun e serisë së vet nga 12 tone të ndryshme, sipas shembullit nga Teksti mësimor. Pas kryerjes së detyrës së

dhënë, mësuesi interpreton të gjitha vargjet dodekafonike, ndërsa më vonë nxënësit zgjedhin më interesantin. E shkruajnë në tabelë.

5. Serinë nga tabela, sipas parimit fotografitë në pasqyrë – në mënyrë inverse, nxënësit e punojnë së bashku, ndërsa mësuesi shkruan notat që i sugjerojnë nxënësit e çdo grupi në mënyrë alternative.

Pamja e tabelës:

Arnold Shhenberg

Pjeri somnambul, Të mbijetuarit e Varshavës

Shkolla vjeneze

Dodekafonia – teknika dymbëdhjetënotëshe

Detyra e zgjedhur dhe inversioni i saj

Igor Stravinski (13)

Qëllimi mësimor:

- * fitimi i njohurive për punën dhe veprën e I. Stravinskit
- * dëgjimi me përjetim i muzikës

Dëgjimi i muzikës:

1. Stravinski: *Petrushka* – valle ruse
2. Stravinski: *Shugurimi i pranverës* - fillimi i pjesës së dytë
3. Stravinski: *Shugurimi i pranverës* - fundi

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
2. dëgjimi dhe analiza e muzikës së Stravinskit
3. njohja me krijimtarinë e Stravinskit
4. formimi i grupeve me detyrë për të menduar koreografi të ndryshme
5. ekzekutimi

1. Dëgjohet fragmenti i valles ruse nga baleti *Petrushka*. Pas dëgjimit i pyet nxënësit, nëse mund të përcaktojnë hapësirën gjeografike nga rrjedh muzika dhe në çfarë ajo i nxit (lojë, vallëzim).
2. Përsëritet dëgjimi me qëllimin që të vërejnë karakterin e kompozimit, tempin, instrumentet që janë në plan të parë (frymore). Informon nxënësit të dëgjojnë muzikën e Igor Stravinskit.
3. Nga Teksti mësimor njoftohen për krijimtarinë e Stravinskit. Lëshohet një fragment nga *Shugurimi i pranverës* (pamje nga Rusia pagane), fillimi i pjesës II. Pas dëgjimit të fragmentit pyet për përshtypjen që u ka lënë. U flet për besimet pagane, ceremonisë përkushtuar Zotit të Pranverës (pleqtë e mençur rrinë në rreth, ndërsa vajza e re me vallen e saj synon të mëshirojë Zotin).



4 dhe 5. Formon grupe me nga 5-6 nxënës i shpërndan në rrahë me detyrën që gjatë dëgjimit të dy fragmenteve nga *Shugurimi i pranverës* të tregojnë projektin e vet koreografik.

Nga nxënësit kërkohet të komentojnë se cila koreografi ka qenë më e suksesshme. Informon nxënësit se Stravinski i ka shkruar baletet e veta për trupën e baletit rus në Paris, të cilën e ka drejtuar Sergej Gjagilev.

Pamja e tabelës

Igor Stravinski
Baleti - Petrushka, Shugurimi i pranverës
Koreograf S. Gjagilev

Punimi i këngës: *M'ka shku mendja o me u fejue (14)*

Qëllimi mësimor:

- *këndimi i këngës sipas tekstit me nota
- *dallimi i karakteristikave të këndimit popullor shqiptar

Dëgjimi i muzikës:

1. *M'ka shkue mendja me u fejue*
- ekzekutim vokalo - instrumental

Hapat kryesorë:

1. Pjesa hyrëse e orës
2. Analiza e tekstit me nota
3. Punimi i ritmit
4. Këndimi sipas shënimit me nota
5. Formimi i grupeve
6. Dëgjimi i këngës nga CD-ja

1. Ora fillon me përsëritjen e ndonjëres nga këngët e mësuara në gjuhën shqipe në klasat e mëparshme. Qëllimi i përsëritjes bëhet që nxënësit të këndojnë duke futur atmosferën e këngës në orë.

2. 3. dhe 4. Të punohet kënga e re me procedimin metodik të propozuar. Lexohet teksti në shqip.

*M'ka shku mendja o me u feju
E me marr një ulqinak
Aman ulqinakun s'ma don nana,
Se m'ka zan i ziu marak.*

*Kur ma ven bohçen e kuqe
Na mbyte me bukuri,
Ani jasaman moj buzburbuqe
As ma fal synin e zi,*

*Si na u ba kjo puna e verit,
Edhe deti çon tallaz,
Ani mos ja prish qejfin beqarit
Zemra i mbushet o me maraz.*

5. Të formohet grupi i djemve dhe grupi i vajzave me detyrën që çdo grup të këndojë strofën e vet nga teksti, me përcjellje instrumentale nga CD-ja.
6. Pas punimit dëgjohet regjistrimi me zë i këngës në CD dhe bisedohet për veçoritë e folklorit.

Vërejtje: Në formën origjinale, këtë këngë e ekzekutojnë njësoj edhe meshkujt, edhe femrat.



Bella Bartok (15)

Qëllimi mësimor:

- * fitimi i njohurive për veprën e B. Bartokut
- * dëgjimi me përjetim i muzikës
- * dallimi i elementeve të muzikës hungareze

Dëgjimi i muzikës:

1. J. Brams, *Valle hungareze nr. 5*
2. B. Bartok, *Koncert për orkestër, Koha III*
3. B. Bartok, *Mandarina e mrekullueshme*, fragment

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
2. i nxit nxënësit të mendojnë dhe bisedojnë për kompozimet e dëgjuara
3. njohja me krijimtarinë e B. Bartokut
4. punimi i këngës së B. Bartokut nga përmbledhja *Mikrokozmos*
5. formimi i grupeve
6. ekzekutimi

1. Dëgjojnë kompozimin e J. Bramsit *Valle hungareze nr.4* dhe i pyet nxënësit, nëse i njohin elementet folklorike dhe a e dinë se për cilin popull janë karakteristike. Thonë emrin e kompozimit dhe emrin e kompozitorit gjerman që i ka përpunuar motivet popullore të muzikës hungareze.
2. Dëgjojnë fragmentin *Koncert për orkestër, koha III* të B. Bartokut dhe bashkë me nxënësit analizojnë motivet folklorike në fragment, paraqesin kompozitorin dhe punën e tij si krijues dhe etnomuzikolog.
3. Lexohen nga Teksti mësimor informacionet për B. Bartokun. Pas leximit dëgjohet një fragment nga *Mandarinë e mrekullueshme*. Pas dëgjimit, tregohet për mandarinën dhe pyeten nxënësit se me çfarë mjetesh është pasqyruar mandarina. Dëgjohet edhe një herë fragmenti me detyrë që të vërejnë karakteristikat e të shprehurit të Bartokut.
4. Me procedimin metodik që propozohet punohet kënga *Erzhi Virag* e B. Bartokut nga përmbledhja e tij *Mikrokozmos*. Kënga të interpretohet me solmizim.
5. 6. Të formohen grupe me detyrë që secila të ekzekutojë këngën.

Pamja e tabelës

- J. Brams, *Valle hungareze nr.5*
- B. Bartok, *Koncert për orkestër, Mandarina e mrekullueshme, Mikrokozmos*

Sergej Prokofjev – Karl Orf (16)

Qëllimi mësimor:

- * njohja e nxënësve me krijimtarinë e S. Prokofjevit dhe K. Orfit
- * dëgjimi me përjetim i muzikës

Dëgjimi i muzikës:

1. S. Prokofjev, Koncert për violinë dhe orkestër nr.1, koha I
2. S. Prokofjev, *Romeo dhe Zhuljeta*, (fragment)
3. S. Prokofjev, *Suita e skitëve*
4. Karl Orf, *Karmina Burana*, (fragment)

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
2. prezentimi i punës së S. Prokofjevit
3. dëgjimi i muzikës së S. Prokofjevit
4. prezentimi i punës së Karl Orfit
5. dëgjimi i muzikës së Karl Orfit

1. Dëgjon një fragment nga Koncerti për violinë dhe orkestër nr.1 të Prokofjevit. I pyet nxënësit, nëse mund të përcaktojnë kohën kur është krijuar kjo vepër dhe mbi çfarë bazohen (ndikimi i stileve të mëparshme).
2. Në bazë të Tekstit mësimor, nxënësit njihen me jetën dhe veprat e S. Prokofjevit. Duhet t'u kujtojë se për mbështetje ka shfrytëzuar përrallat ruse.
3. Lëshon një fragment nga baleti *Romeo dhe Zhuljeta* me detyrë që të përshkruajnë atmosferën që pasqyron muzika. Pyet nëse dikush e di tregimin për Romeon dhe Zhuljetën dhe pastaj bisedohet për muzikën si interpretuese e veprimit dramatik. Si antitezë e stilit që tregohet në baletin *Romeo dhe Zhuljeta*, dëgjohej një fragment nga *Suita e skitëve*, me qëllim që të dallojnë ndryshimet stilistikore të krijimit të S. Prokofjevit.
4. Pas dëgjimit të fragmentit të S. Prokofjevit paraqet punën e bashkëkohësit të vet K. Orf, i cili në veprën e vet *Karmina Burana*, gjithashtu si bazë ka shfrytëzuar një themel letrar, por me tregim tjetër (nga manastiri) për veprën e vet më të rëndësishme. Krahason dhe shpjegon llojshmërinë e të shprehurit stilistik të dy kompozitorëve në orvajtjen që me muzikë dhe formë të prezantojnë veprat ekzistuese.
5. Pas njohjes me punën e K. Orfit, lëshohen fragmente nga kantata skenike *Karmina Burana*. Pas dëgjimit, bisedon me nxënësit për ngjashmëritë dhe dallimet mes veprave të dëgjura.

Pamja e tabelës

Sergej Prokofjev, Koncert për violinë dhe orkestër nr.1, Suita e skitëve
Baleti “Romeo dhe Zhuljeta”
Karl Orf, Karmina Burana



Rondo – Karl Orf (17)

Qëllimi mësimor:

* ekzekutimi i rondosë ritmike

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
2. analiza e shënimit ritmik
3. formimi i grupeve
4. puna me grupe - kombinimet
5. ekzekutim i përbashkët

Vërejtje: Për nevojat e kësaj ore është e domosdoshme të gjinden pjesë nga instrumentet orfeane (shkopinj druri, raketake, çinjelle të vogla, dajre, lodra...). Nëse shkolla nuk i ka këto instrumente, mund të improvizohen nga bishta fshesash të vjetra, lapsa druri, shishe boshe plastike, kuti të mbushura me kokrra, oriz, rërë, gurë etj.

1. Me dëgjimin e fragmentit nga *Karmina Burana*, nxënësit përkujtohen në krijimtarinë e K. Orfit dhe veçanërisht punën e tij të lidhur me pedagogjinë muzikore.
2. Analizohet shënimi ritmik. U sqarohet nxënësve se në ç'mënyrë Orfi e ka menduar ekzekutimin e Rondosë, llojshmërinë e mjeteve goditëse, pjesëmarrjen e të gjithëve, pastaj solistëve. Sqaron nevojën për ekzekutim preciz të ritmit për të arritur efektin përkatës.
3. Formimi i grupeve duhet të bëhet sipas aftësive të nxënësve që të kontrollojnë lëvizjet me dorë, për punimin e shpejtë dhe të lehtë të pjesëve. Nxënësit me koordinim më të dobët të futen në grupe, të cilave do t'u jepet ritëm më i thjeshtë (vlera më të gjata të notave, një deri në dy lëvizje) pranë nxënësit që di të gjendet mirë. Nxënësit e tjerë të ndahen në grupe sipas shënimit ritmik, numrit të mjeteve në dispozicion, veçorive – sipas zgjidhjes.
4. Me çdo grup në veçanti të punohet pjesa ritmike që u është ngarkuar, së pari pa dokumenta dhe më pas me ta.
Me përvetësimin e ritmit, bëhet bashkimi i grupeve të ndryshme në kombinime të ndryshme nga dy dhe nga tri, deri sa të arrijnë të përvetësojnë formën themelore të dhënë.
5. Grupet shpërndahen nëpër klasë – podium dhe së bashku ekzekutojnë veprën e punuar.

Pamja e tabelës

Rondo, Karl Orf

Oliver Mesian – Benxhamin Britën (18)

Qëllimi mësimor:

- * njohja e nxënësve me krijimtarinë e O. Mesianit dhe B. Britnit.
- * dëgjimi me përjetim i muzikës

Dëgjimi i muzikës:

1. O. Mesian, *Lindja e Zotit*
2. O. Mesian, *Zogjtë egzotikë*
3. B. Britën, *Piter Grajms – Interludi Mëngjesi i të dielës*

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
2. prezentimi i punës së Mesianit
3. dëgjimi i muzikës së Mesianit
4. prezentimi i punës së Britënit
5. dëgjimi i muzikës së Britënit

1. Me dëgjimin e kompozimit të Mesianit *Lindja e Zotit*, u kujton nxënësve organon, instrument që e kanë mësuar në kuadër të muzikës së barokut. Përsëriten karakteristikat themelore të instrumentit – pjesët dhe përdorimi.

2, 3. Duke u mbështetur në informacionet nga Teksti mësimor, të paraqitet puna e Mesianit dhe ndikimi religjioz në një pjesë të veprave të tij. Përsëritet dëgjimi me qëllim që ky kompozim të krahasohet me ndonjë nga baroku që e kanë mësuar në klasën VII: motorika barokiane dhe zbatimi i temës përmes tingujve me serinë e notave që janë prezente tek Mesiani.

Dëgjohet një fragment nga *Zogjtë ekzotikë* për t’u paraqitur pjesa e dytë e rëndësishme e opusit të Mesianit, kushtuar zogjve. Duke komentuar kompozimin, nxënësit njohin ndonjë zog dhe përshkruajnë mënyrën se si e ka pasqyruar kompozitori: me cilat instrumente, me çfarë notash etj. U propozon nxënësve që me ndihmën e telefonëve celularë ose ndonjë mjeti tjetër të incizojnë cicërrimën e zogjve nga rrethina e vet.

4. 5. Pas dëgjimit të fragmentit nga opera *Piter Grajms* kërkon nga nxënësit të përshkruajnë atmosferën dhe përjetimin personal të veprës, Me ndihmën e Tekstit mësimor, nxënësit informohen për krijimtarinë e Britënit dhe njihen me përmbajtjen e shkurtër të operës. Interludi me nëntitullin *Mëngjesi i të dielës* i kushtohet detit, prandaj gjatë dëgjimit të dytë, kërkohet nga nxënësit të njohin elementet muzikore dhe ngjyrat që pasqyrojnë detin.

Pamja e tabelës

Mesian, “Lindja e Zotit”, “Zogjtë ekzotikë”
Britën, “Piter Grajms”



TENDENCAT E REJA (19, 20, 21)

Për shkak të vëllimit të materies, është parashikuar që “Tendencat e reja” të punohen në tri orë mësimore dhe shprehimisht njohja me kompozitorët dhe drejtimet në dy orë, ndërsa eksperimentimi me mundësi zërore të ndryshme, në një orë.

Qëllimi mësimor:

- * fitimi i njohurive për tendencat e reja në muzikën e shekullit XX
- * njohja me kompozitorët dhe drejtimet muzikore
- * eksperimentimi me tinguj të ndryshëm

Dëgjimi i muzikës:

1. Varez, *Poema elektronike*
2. Shtokhauzen, *Kuarteti i harqeve të helikopterit*
3. Penderecki, *Vajtimi i viktimave të Hiroshimës*
4. Gllas, *Ajnshtajni në plazh*
5. Shnitke, fragment nga simfonia II
6. Part, *Silenzio*

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
 2. prezentimi i punës së kompozitorëve
 3. dëgjimi i muzikës i autorëve të ndryshëm
 4. ndarja në grupe
 5. eksperimentimi në vendet e punës së grupeve
 6. zgjedhja e punimeve më të suksesshme
1. Në pjesën hyrëse të orës të bisedohet me nxënës për përparimin teknologjik gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX, i cili ka kushtëzuar lindjen e artit të ri dhe muzikës së re.
 2. dhe 3. Me dëgjimin e fragmenteve të zgjedhura nga kompozimet e dhëna, të njihen nxënësit me krijimtarinë e autorëve të tyre. Nxënësit të njohin instrumentet, aparatet, ngjyrat e reja tingullore, mënyra të reja të përdorimit të instrumenteve, të komentojnë përdorimin e zërit të njeriut. Bisedohet për arsytet dhe ngjarjet që i kanë frymëzuar autorët. Analizohen fragmentet e dëgjuara dhe nxiten nxënësit për të arsyetuar për modelin e mundshëm muzikor- formën e pjesëve të veçanta.
 4. Në fund të orës së dytë, nxënësit ndahen në shumë grupe me 3-4 nxënës me detyrë që çdo grup të përfytyrojë dhe të punojë mjete që prodhojnë tinguj.
 5. Në orën e tretë, grupet e formuara bëhen ansamble të vogla të llojit të vet dhe demonstrojnë mënyrën e përdorimit të “instrumenteve” të bëra, duke ekzekutuar kompozimet e veta.
 6. Zgjedhin bashkë instrumentet më interesante dhe kompozimet dhe pastaj i incizojnë me ndihmën e telefonave celularë. Riprodhohet incizimi, si edhe një mundësi eksperimentimi me tingullin, pastaj komentohet.

Pamja e tabelës

Emrat e kompozitorëve dhe emërtimet e veprave, fragmentet e të cilave i kanë dëgjuar.

MUZIKA NË MALIN E ZI NË SHEKULLIN XX (22)

Qëllimi mësimor:

- * njohja me krijimtarinë e kompozitorëve malazezë në gjysmën e dytë të shekullit XX
- * këndimi i këngës *Kalova nëpër mal (Prođoh kroz goru)* sipas tekstit me nota
- * vërja re e karakteristikave të folklorit malazez

Dëgjimi i muzikës:

1. Taminxhiq, fragment nga *Tufa e parë*
2. Punimi i këngës *Prođoh kroz goru (Kalova nëpër mal)*
- ekzekutimi vokalo-instrumental (masa 4/4)
3. Punimi i këngës *Prođoh kroz goru (Kalova nëpër mal)*
- ekzekutimi instrumental (masa 3/4)

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
 2. informim mbi krijimtarinë e kompozitorëve malazezë
 3. dëgjimi analitik i muzikës
 4. analiza e tekstit me nota
 5. punimi i ritmit
 6. këndimi sipas shënimit me nota
 7. dëgjimi i këngës nga CD-ja
 8. dëgjimi dhe këndimi i këngës popullore në mënyrë artistike
1. Ora fillon me përsëritjen e ndonjëres prej këngëve të mësuara në klasën e kaluar me qëllim këndimi dhe krijimi të atmosferës së orës. Për këtë qëllim, më e përshtatshme është kënga *Margaritari Marë (Biser Mara)* për shkak të lidhjes me autorin B. Taminxhiq, krijimtaria e të cilit do të prezantohet.
- 2, 3. Me ndihmën e Tekstit mësimor të informohen nxënësit për krijimtarinë e kompozitorëve malazezë të gjysmës së dytë të shek.XX. Dëgjojnë fragmentin nga *Tufa e këngëve* të Taminxhiqit dhe bisedohet me nxënësit për elementet muzikore të kompozimit: tema, melodija dhe ritmi. Tek dëgjimi i përsëritur me kujdes të shihet teksti dhe punimi i tij muzikor. Kërkohet nga nxënësit të njohin elementet folklorike dhe mënyrën e zbatimit në muzikën klasike.
- 4, 5 dhe 6. Të punohet kënga sipas procesit metodik të propozuar.



7. Dëgjohej versioni i parë i regjistrimit me zë nga CD-ja, punimi tradicional në masën 4/4, në mënyrën siç ekzekutohet kjo këngë më shpesh sot.
8. Informon nxënësit se folklori u ka shërbyer shumë autorëve të muzikës klasike si bazë për krijimin e veprave të tyre, prandaj të dëgjohej versioni instrumental i këngës në masën 3/4, të shkruar me ritmin e boleros.
- Kërkon nga nxënësit të njohin ritmin dhe melodinë dhe pastaj me parimin “karaoke” mundohen ta këndojnë versionin e tillë të këngës.
- Krahasohen dy versionet me qëllimin që nxënësit të njohin mundësitë si varion muzika popullore.
- Përshtatjen për këngët popullore e ka punuar Sasha Taminxhiq, i biri i kompozitorit Bora Taminxhiq.

MUZIKA XHAZ (23, 24, 25)

Për shkak të vëllimit të materies është paraparë që kjo temë të zhvillohet gjatë tri orëve; historiku i muzikës xhaz, njohja me stilet dhe autorët gjatë dy orëve dhe pastaj punimi i këngës “Summertime” sipas tekstit me nota në një orë.

Qëllimi mësimor:

- * fitimi i njohurive për lindjen e muzikës xhaz
- * njohja me historikun dhe stilet e muzikës xhaz
- * mësimi i këngës sipas shënimit me nota
- * arritja e njohurive për lidhjen e muzikës klasike me atë të xhazit dhe krijimtaria e Gershvinit.

Dëgjimi i muzikës:

1. Horace Silver, “Sister Sadie”
2. Bluz, Soni Boy Williams
3. Spiritual, “Oh, Happy Day”
4. Regtajn, “The entertainer” Scot Joplin
5. Luis Armstrong, Bugle call rag Monday Date
6. Lulluby of Birdland, Sarah Vaughn
7. The Preacher’ Horace Silver
8. Summertime
9. Summertime – punimi, ekzekutimi vokalo-instrumental

Hapat kryesorë:

1. Pjesa hyrëse e orës
2. Informim mbi lindjen e xhazit
3. Informim mbi elementet e muzikës së xhazit
- 4, 5, 6, 7. Dëgjimi analitik i muzikës

- 8 Informim mbi rolin shoqëror të xhazit
- 9. Njohja me improvizimin si elementi më i rëndësishëm i muzikës xhaz
- 10. Njohja me mënyrën specifike të këndimit
- 11. Njohja e modeleve ritmike karakteristike
- 12, 13, 14. Punimi i këngës *Summertime*

1. Dëgjohet kompozimi nr. 1 dhe kërkohet nga nxënësit të njohin se për cilin lloj të muzikës bëhet fjalë. Kur të vertetohet se është fjala për xhazin, të stimulohen nxënësit të shprehin përjetimin e vet dhe asocimet e veta që i lidhin me muzikën e xhazit.

2. Duke u mbështetur në vëzhgimin e nxënësve dhe përshtypjet e përgjithshme, fillon biseda për historikun e muzikës xhaz, me theks në faktin se muzika xhaz ka lindur në shekullin XX në truallin e Amerikës Veriore dhe që sot konsiderohet si i vetmi kontribut autentik i kombit amerikan për kulturën botërore.

Nxiten nxënësit që në vija të shkurtra të kujtojnë historinë e Amerikës që nga zbulimi i Kolombit në shekullin XV, përmes popullimit me evropianë deri tek bumi ekonomik dhe statusi i sotëm i ShBA-së në botë. U kujton fëmijëve se zhvillimi i shpejtë dhe dinamik i Amerikës nga shekulli XVII deri në shekullin XIX është bazuar në fuqinë e lirë punëtore dhe në sistemin e ri të pronësisë mbi mallin. Në hartën gjeografike të botës të tregohet bregdeti perëndimor i Afrikës dhe rruga detare deri në Amerikën Veriore, përmes së cilës tregtarët e mallrave kanë kaluar me mijëra afrikanë në pronat e ardhacakëve të bardhë.

Komentohet me nxënës pozita e rëndë dhe johumane e robërve të zinj, krahas insistimit të tyre për të shprehur qëndrimet e veta për robërinë dhe përpjekjes për të shprehur ndjenjat e veta në lidhje me të.

3. U kujton nxënësve lëndën e muzikës të kohërave të kaluara, e cila si njësi mësimore është mësuar në klasën VII në shembullin e muzikës së fiseve afrikane. U kujton rëndësinë e ritmit dhe goditëseve në muzikën e Afrikës dhe përmes diskutimit me nxënës të krahasohet me traditën muzikore evropiane, në të cilat meloditë dhe harmonia janë në plan të parë. U sqaron nxënësve se robërit në atdheun e tyre të ri, në shtëpitë e zotërinjve të bardhë, për herë të parë kanë dëgjuar muzikën evropiane (folklorin e popujve të ndryshëm ardhacakë, muzikën klasike dhe këngët popullore të asaj kohe) dhe se brezat e ardhshëm të robërve të lindur në Amerikë kanë krijuar spontanisht format e reja të shprehurit muzikor, të cilat kanë qenë bazuar në trashigiminë afrikane, por edhe njëkohësisht edhe në ndikimin e fortë të melodive dhe harmonisë së ardhacakëve të bardhë. Të thuhet se ai ka qenë procesi që ka vazhduar gati dy shekuj dhe që krijuesit zezakë kanë qenë autodidaktë, ndërsa muzika e tyre e papranuar nga popullata e bardhë dhe e segreguar (dalluar) nga ana racore.

4. Të dëgjohet shembulli muzikor **i bluzit**; kërkohet nga nxënësit komente për atmosferën e këngës, karakterin. Të sqarohet se bluzi ka qenë model vokalo-instrumental i robërve zezakë, kënga me të cilën punohen temat nga jeta e përditshme zakonisht të trishtuara (“blue” në anglisht do të thotë “trishtuar”). Në shembullin muzikor bashkë me nxënësit numërojnë numrin e takteve të temës (12), gjë që është veçoria themelore e bluzit.



5. Të dëgjohet shembulli i **spiritualizmit** dhe provokohen nxënësit që të përqëndrojnë vëmendjen në tekst (religjioz, përmendet Jezusi dhe dita e lumtur kur kur ai do të fitojë dhe do të lajë të gjitha gjynahet tona). Të sqarohet se robërit nga Afrika janë shëndrruar në të krishterë, por për arsye të racizmit, kishat e tyre dhe shërbimet fetare kanë qenë të ndara nga të bardhët. Krahaso muzikën shpirtërore të zezakëve me atë të Evropës. (karakteri i ekzaltuar laik përballë atij festiv dhe monumental).
6. Të dëgjohet **regtajmi** dhe të sqarohen se pas çlirimit nga robëria, disa muzikantë zezakë në Nju-Orleans kanë krijuar muzikë popullore, e cila është shkruar për piano-regtajm. Shikojnë me kujdes në ritmin e sinkopuar (regtajm në përkthim do të thotë “ritëm i copëtuar”).
7. Dëgjohet shembulli i L. Armstrongut dhe nga nxënësit kërkohet të dallojnë instrumentet (trumbetë, klarinetë, lodra, kontrabas dhe kitarë). Thuhet se Luis Armstrongu është ylli i parë i muzikës xhaz, me origjinë nga Nju-Orleansi, i cili, ekzekutimin me trumbetë e ka ngritur teknikisht në kulm dhe ka vendosur qartë drejtimet stilistike të muzikës xhaz në përgjithësi.
8. Në hartë tregon Nju - Orleansin dhe deltën e Misisipit dhe pasyron atmosferën e gjallë të qytetit port në kalimin nga shekulli XIX në shekullin XX dhe i sqaron se në atë qytet ka lindur muzika që ka bashkuar të gjitha format ekzistuese të krijimtarisë popullore të zezakëve në Amerikë. Kjo muzikë e re është quajtur xhaz. Ajo është ekzekutuar në rrugë, në ditë festash, vdekjesh, paradash, si edhe në sallonet dhe anijet që kanë lundruar në deltën e Misisipit. Në atë kohë kanë lindur shumë orkestra dhe solistë, të cilët e kanë bërë të famshëm këtë qytet.
9. Me dëgjimin e Lulluby provokohet biseda me nxënës me pyetjen se çfarë të re dhe të pazakontë vërejnë në ekzekutimin që kanë dëgjuar (ndërrimi i solistëve të ndryshëm në një pjesë muzikore, lidhja e solistëve, këndimi pa tekst...)

Duke u mbështetur në vërejtjet e nxënësve, fillon biseda për improvizimin si karakteristika bazë e muzikës xhaz. I pyet nxënësit se çfarë kuptojnë me nocionin “improvizim”, duke insistuar që nxënësit të japin shembuj nga jeta e përditshme p.sh. ritregimi i ndonjë teksti me “fjalët e veta”, shkrimi i një hartimi në temën e dhënë, ardhja deri tek zgjidhja e ndonjë problemi në mënyrë të ndryshme etj.). Me krahasimin e shembujve të dhënë nga jeta e përditshme sqarohet se improvizimi në xhaz do të thotë “ritregim me fjalë të veta” i këngës së dhënë. Sqarohet parimi karakteristik për xhazin, që çdo muzikant në orkestër ka detyrën që në kompozimin e zgjedhur pas ekzekutimit të temës, e cila është shkruar dhe është gjithnjë e njëjtë, në solot e veta “të sajojë” melodinë e re në skeletin ekzistues ritmik dhe harmonik të këngës. Kjo liri e madhe për secilin muzikant, në kuadër të formës së këngës, është baza dhe qëllimi kryesor dhe ndan qartë xhazin nga zhanret e tjera muzikore.
10. Përsëri dëgjojnë shembullin dhe tani analizojnë pjesën me nxënësit. U tërheq vëmendjen që vokali këndon kompozimin e njohur në fillim ashtu siç e ka shkruar kompozitori, me tekst, dhe pastaj në skeletin e njëjtë harmonik, duke ndjekur formën **aaba** e “rikomponojnë” këngën, e “rikëndojnë” solistët – pianisti, basisti, në lodra, vokal, saksofon, trumbetë etj. Në

fund në pjesën **b** kthehen të gjithë në temën dhe kështu përfundon pjesa. U sqaron nxënësve se kjo temë – shabllon është solo korusi në të cilën ndërrohen instrumente të ndryshme-model i zakonshëm i improvizimit në xhaz. Tërhiqet veëmendja në rolin e këngëtarit i cili këndon solo pa tekst, duke imituar instrumentin, çfarë është risi që futi Luis Armstrongu dhe që quhet “skat” (sket).

11. Pulsu karakteristik ritmik i xhazit, i njohur me emrin “sving” ose “lëkundje”, sqarohet në shembullin muzikor *The preacher*. Kërkon nga nxënësit që gjatë dëgjimit, të trokasin me duar, kërcasin me gishtërinj, të lëkunden sipas ritmit dhe me trupin e vet të ndjejnë kohën e dytë dhe të katërt të masës 4/4. U kujton se rëndësia e ritmit, të marrë nga koncepti muzikor afrikan është edhe një karakteristikë tjetër e muzikës së xhazit.
12. Tregohet shembulli muzikor me nota nga Teksti mësimor dhe tregon se kompozimi “Summertime” është arie nga opera “Porgi dhe Bes” të cilën e ka shkruar kompozitori amerikan i muzikës serioze Xhorxh Gershvin, i frymëzuar nga muzika xhaz dhe jeta e zezakëve. Kjo arie, ninulla me të cilën zezakja qetëson fëmijën e vet, është pranuar nga muzikantët e zhazit si një ndër temat më të njohura, prandaj si e tillë ka përjetuar versione të ndryshme.

*Summertime and the livin' is easy,
Fish are jump in'
an' the cotton is high.
Oh, yo' daddy's rich,
an' yo' ma is good lookin,
So hush little baby don't yo' cry.*

*Është verë dhe jetohet lehtë
peshqit kërcëjnë
dhe pambuku është rritur.
Është i pasur babi yt,
ndërsa mami është e bukur:
prandaj fli, bebëz e mos qaj.*

*One of these mornin's
You goin' to rise up singin',
Then you'll spread your wings
and you'll take the sky.
But till that mornin'
There's a nothing can harm you
With dady and mammy standin' by.*

*Në një mëngjes,
do ngrihesh duke kënduar
dhe do t'i hapësh krahët
e qielli do të jetë yti.
Por deri n'at mëngjes
Asgjë s'mund të të lëndojë,
Se babi dhe mami janë pranë teje.*

Kënga punohet sipas procedimit metodik të parashtruar.

13. Me nxënësit këndohet përsëri *Summertime* me tekst dhe me shoqërim instrumental nga CD-ja.
14. Në fund të orës dëgjohej pjesa nga CD-ja dhe komentohet mënyra e ekzekutimit.



MUZIKA E POPULLARIZUAR (26)

Në orën që i paraprin kësaj njësie mësimore është e domosdoshme të ndahen nxënësit në grupe të vogla me detyrë që të përgatisin regjistrimin me zë të grupit që dëshirojnë, të këngës apo solistit dhe një informacion të shkurtër për të.

Qëllimi mësimor:

- * fitimi i njohurive për muzikën e popullarizuar
- * njohja me autorët, grupet dhe solistët e muzikës së popullarizuar
- * mësimi i hapave të vallëzimit

Dëgjimi i muzikës

1. **E. Prilli**, *Don't be Cruel*
2. **Bitëllsat**, *Yesterday*
3. **Rollingstonsat**, *Satisfaction*
4. **Pink flojd**, *Another brick in the wall*
5. **Madona**, *Frozen*
6. **Sting**, *Fragille*

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
 2. dëgjimi dhe analiza e fragmentit të muzikës së popullarizuar
 3. informim mbi autorët, grupet dhe solistët më të rëndësishëm
 4. raportimet e grupeve
 5. mësimi dhe ekzekutimi i hapave të vallëzimit
1. Në pjesën hyrëse bisedohet për praninë e përgjithshme të muzikës së popullarizuar në jetën e përditshme dhe në media.
 2. Dëgjohen fragmente nga pjesët e zgjedhura pastaj bisedohet për elementet e kësaj muzike (melodia dhe ritmi), për ekzekutuesit, instrumentet dhe mënyrën e përdorimit të tyre dhe pajisjeve teknike të domosdoshme për interpretimin e këtij lloji të muzikës.
Nxit nxënësit që të arsyetojnë se çfarë i ka kontribuar popullaritetit të madh të kësaj muzike si dhe rolin e medieve në përhapjen e saj.
 3. Me ndihmën e Tekstit mësimor nxënësit informohen mbi lindjen e muzikës së popullarizuar, me drejtimet më të rëndësishme dhe përfaqësuesit e saj.
 4. Grupet e formuara që më parë demonstrojnë regjistrimet me zë duke i komentuar.
 5. Muzikën e popullarizuar e ndjekin rregullisht hapa kërcimi të përcaktuar, prandaj kërkohet që nxënësit t'i mësojnë me ndihmën e mësuesit (ose të ftuarit nga studioja e kërcimit).

Pamja e tabelës

Emrat e drejtimeve më të rëndësishme të muzikës së popullarizuar dhe të përfaqësuesve të tyre.

MUZIKA FILMIKE (27)

Qëllimi mësimor:

- * fitimi i njohurive për muzikën filmike
- * njohja me autorët e muzikës filmike
- * dëgjimi analitik i muzikës filmike

Dëgjimi i muzikës:

1. **Viliams**, tema nga filmi *Peshkaqeni*
2. **Viliams**, tema nga filmi *E.T.*
3. **Morikone**, tema nga filmi *I mirë, i keq, i lig*
4. **Morikone**, tema nga filmi *Misioni*
5. **Llej**, tema nga filmi *Tregim dashurie*
6. **Mansini**, tema nga filmi *Pink Panter*

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
 2. dëgjimi dhe analiza e fragmentit të muzikës filmike
 3. informim mbi autorët më të rëndësishëm të muzikës filmike
 4. formimi i grupeve
 5. raportimet e grupeve
1. Dëgjohet tema nga filmi *Peshkaqeni*, pyeten nxënësit, nëse e njohin dhe për cilin lloj muzike bëhet fjalë. Me këtë shembull i fut në një zhanr të ri të muzikës, në atë filmike.
 2. Dëgjojen fragmente nga shembujt e zgjedhur të muzikës filmike, pastaj bisedohet për rolin që ka muzika në film dhe në elementet e muzikës filmike.
 3. Me ndihmën e Tekstit mësimor i informon nxënësit mbi autorët më të rëndësishëm të muzikës filmike dhe për veprat e tyre.
 4. Formon katër grupe me detyrën që çdo grup, në bazë të shembujve të dëgjuar, të përgatitë një koment të shkurtër për:

Grupi I - Xh. Viliamsin;
Grupi II - Xh. Hornerin;
Grupi III - E. Morikonen;
Grupi IV - F. Llein.

5. Përfaqësuesit e grupeve ekspozojnë komentet të mbështetura me shembujt me zë.

Pamja e tabelës

Emrat e autorëve më të rëndësishëm të muzikës filmike



Kanon – Dona nobis Pacem (28)

Qëllimi mësimor:

- * përforcim i njohurive të fituara më parë për kanonin
- * punimi i kanonit sipas tekstit me nota
- * dëgjimi i kanonit

Dëgjimi i muzikës:

1. Kanoni – dyzërësh ose trezërësh, i punuar në klasat e mëparshme: I dashuri bato, Viva la musica...

Hapat kryesorë:

1. pjesa hyrëse e orës
2. analiza e tekstit me nota
3. punimi i ritmit
4. këndimi sipas shënimit me nota
5. formimi i grupeve
6. ekzekutimi

1. Ora fillon me kujtimin e kanoneve të mësuara më parë dhe në parimin e të kënduarit me imitimin e zërave.
- 2, 3, 4. Të punohet kanoni sipas procedimit metodik të parashtruar. Nga nxënësit kërkohet të vërejnë frazat që ndajnë debutimin e zërave.
- 5 dhe 6. Formon grupe dhe me secilën konfirmon melodinë e kanonit. Grupet futen në këndimin mes tyre (provohen 2 nga 2 zëra) deri sa ta realizojnë me sukses debutimin e vet. Pas përvetësimit të fillimit të ekzekutimit, çdo grupi i cakton radhën e ekzekutimeve, me mundësinë që në ekzekutimet e ardhshme ajo renditje të jetë ndryshe. Nëse numri i caktuar i nxënësve tregon interesim për ekzekutim të pavarur, provohet debutimi me zëra të veçantë (individualë).

LITERATURA:

- Xh. Abraham: *Historia e Oksfordit për muzikën*, CLIO, 2001.
- L. Alberti: *Muzika ndër shekuj*, Vuk Karaxhiq, Beograd, 1974
- J. Andreis: *Povijest glazbe Liber Mladost*, Zagreb, 1974
- R. Pejoviq: *Historia e muzikës*, Enti i Teksteve mësimore i Serbisë, Beograd, 1967.
- S. Marinkoviq: *Historia e muzikës*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Beograd, 1997.
- A. T. Davison- W. Apel: *Historical Antology of Music*, Harvard University press
- K. Michael: *The Oxford Dictionary of Music*, Oxford University press
- K.H. Ehrenforth: *Zhvillimi i pedagogjisë muzikore*, SCHOTT, Berlin, 2005
- D. Skovran – V. Periçiq: *Shkenca mbi format e muzikës*, Universiteti i artit, Beograd
- C. Kohoutek: *Teknika e kompozimit në muzikën e shek. XX*, Universiteti i artit Beograd, Beograd, 1969
- D. Plavsha: *Muzika nga aspekte të ndryshme*, Enti për botimin e librave, Beograd 1969.
- D. Kuk: *Gjuha e muzikës*, Nolit, Beograd, 1982
- Enciklopedia muzikore, *Enti leksikografik jugosllav*, Zagreb, 1977.
- M. Wade – M e W Tompson: *Muzika*, Enciklopedi e ilustruar e kompozitorëve të mëdhenj, JRJ, Zemun
- M. Vasileviq: *Meloditë popullore në Mali të Zi*, Instituti muzikologjik, Beograd, 1965.
- J. Millosheviq: *Shënime për këngët popullore nga Mali i Zi*, Paraqitjen e përgatiti mr. Z. Marjanoviq, UKCG, 2000.



CIP - Каталогизација у публикацији
Централна народна библиотека Црне Горе, Цетиње

371 . 3 : 78 (035)

POPOVIĆ, Dobrila

Kultura muzikore 9 : për klasën e nëntë të shkollës fillore nëntëvjeçare : manuali për mësuesit / Dobrilla Popoviq, Milloshg Zatkallik, Darko Todiq ; [përkthyes Luigj Dedvukaj ; grafika e notave Aleksandër Taminxhiq] . - Podgoricë : Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore, 2009 (Podgorica : Studio Mouse) . - 40 str. : ilustr. ; 26 cm + CD 2

Tirazh 50. - Bibliografija: str. 39.

ISBN 978-86-303-1425-4

1. Zatkallik, Miloš [аутор] 2. Tadić, Darko [аутор] - I. Popoviq, Dobrila v. Popović, Dobrila

a) Музичка култура - Настава - Методика - Приручници
COBISS.CG-ID 14723088